

VENDIM
Nr. 489, datë 9.8.2023

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË PËR NDRYSHIMIN E
KONTRATËS SË KONCESIONIT “PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE
MONITORIMIT TË KARBURANTEVE, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË
SË FINANCIVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT TË
PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE ‘GLOBAL FLUIDS INTERNATIONAL’ S.A.
DHE ‘PETROLEUM CONSULTING PARTNERS’ A.G.”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 200, DATË 13.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive ‘Global Fluids International’ S.A. dhe ‘Petroleum Consulting Partners’ A.G.”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit të aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS

I KONTRATËS SË KONCESIONIT PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE

Sot, në Tiranë, më 04.08.2023, palët e mëposhtme:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si **"Autoriteti Kontraktues"**;

dhe

2. PETROLEUM CONSULTING PARTNERS LLC., një shoqëri e regjistruar në Delaware, Shtet e Bashkuara të Amerikës, me nr. dosje 7672752, më parë quajtur Petroleum Consulting Partners A.G., regjistruar Zug, Zvicër me numër regjistrimi CHE-374.049.957 (1034-508-84);

SICPA Global Fluids Integrity S.A, një shoqëri e regjistruar në kantonin Vaud në Zvicër, me nr CHE-342.404.735, më parë quajtur Global Fluids International S.A., regjistruar nw St. Christopher dhe Nevis, me numër regjistrimi C.20985; (referuar bashkërisht si **"Koncesionari"**)

Shoqëria "GFI ALBANIA" SHPK, me NUIS L31605014G, në vijim referuar si **"Shoqëria Koncesionare"**

referuar në vijim së bashku si **"Palët"**.

bazuar në Nenin 31 të Ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partenritetin publik privat" i ndryshuar lidhet ky aneks për ndryshimin e Kontratës së Koncesionit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve.

DEKLARIME PARAPRAKE:

1. Mes Autoritetit Kontraktues dhe Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive Global Fluids International S.A. (GFI) dhe Petroleum Consulting Partners A.G. (PCP) është lidhur kontrata e Koncesionit datë 23.02.2013 (në vijim **"Kontrata"**), miratuar me VKM nr.200, datë 13.3.2013 "Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive "Global Fluids International" S.A. dhe "Petroleum Consulting Partners" A.G.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 7.2.2 (iv) të Kontratës së Koncesionit, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ka themeluar në datën 22.03.2013 shoqërinë GFI ALBANIA SHPK, e cila në vijim ka zbatuar parashikimet e kontratës së koncesionit.
3. Si rezultat i kërkesës së Autoritetit Kontraktues, pa pasur asnjë paragjykim mbi pretendimet e Koncesionarit të rrjedhura nga zbatimi i Kontratës së Koncesionit bazuar



në nenin 4.5, pika (ii) të Kontratës, mes Palëve janë dakordësuar kushtet e ndryshimit të Kontratës si vijon:

Neni 1

Në nenin 4, pika 4.1 e Kontratës ndryshon si vijon:

4.1. Kohëzgjatja e Koncesionit është 11 (njëmbëdhjetë) vjet duke filluar nga Data Efektive.

Neni 2

Në nenin 19, pika 19.1. ndryshon si vijon:

19.1. Kontrata e Koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 11 (njëmbëdhjetë) vjeçar të përcaktuar në nenin 4.1. të kësaj Kontrate.

Neni 3

Në nenin 22.5. "Njoftimet" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Autoriteti Kontraktues

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, 4, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2228494

e-mail: info@financa.gov.al

Koncesionari:

Adresa: GFI ALBANIA SHPK, Autostrada Tiranë-Durrës, km6, Mëzez, Tiranë,

Shqipëri

Tel: +3552242932


e-mail: office@gfi-albania.com

Neni 4

Parashikimet e tjera të Kontratës mbeten të pandryshuara.

Për Autoritetin Kontraktues

Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Znj. Delina Brahina



**Për Koncesionarin dhe
Shoqërinë Koncesionare**

Z. Ergys Sela

Ergys Sela